

STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"Kalaja e Bardhë".

Në këtë dokument, nëse nuk përcaktohet ndryshe, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

"Ligji Tregtar":	Ligji nr. 9901 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar;
"Statuti":	Statuti i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar " Kalaja e Bardhë " Shpk.
"Shoqëria":	Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar " Kalaja e Bardhë " Shpk.
"Themeluesit":	Themeluesit e Shoqërisë, përcaktuar në nenin 1 të Statutit.
"Ortaku(ët)":	Sipas rastit, personi(at) fizik a juridik që mbajnë këtë cilësi në Shoqëri në përputhje me kërkesat e nenit 5 dhe 6; Kur një kuotë e Shoqërisë zotërohet nga më shumë se një person fizik a juridik (bashkëzotëruarit), këta persona në marrëdhëniet juridike me Shoqërinë trajtohen bashkërisht si një Ortak.
"Ortaku Nënshkrues"	Personat fizik a juridik që kanë nënshkruar kuotën me kontribute në para, në emër të tyre apo në bashkëzotërim me persona të tjerë, por që nuk kanë shlyer plotësisht shumën e nënshkruar. Ortaku Nënshkrues gëzon të drejta të kufizuara siç përcaktohet në këtë Statut.
"Website":	Hapësira në Internet e Shoqërisë.
"Dite të plota":	në lidhje me llogaritjen e afateve, është periudha kohore që nis nga dita vijuese e datës kur njoftimi është marrë ose konsiderohet i marrë.

Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera që Shoqëria i drejton ortakeve sipas këtij Statuti do të bëhen me shkrim dhe do të konsiderohen se janë kryer në mënyrë të rregullt kur u dërgohen Ortakeve në adresat e deklaruara prej tyre pranë Administratorit(ëve) të Shoqërisë.

Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera që Shoqëria i drejton Ortakeve sipas këtij Statuti do të konsiderohen se janë kryer në mënyrë të rregullt për Ortakun të cilit këto i drejtohen, e për çdo qëllim nëse: (i) njoftimi, kërkesa ose komunikimi i është dorëzuar personalisht Ortakut ose përfaqësuesit të tij; (ii) i është dërguar me poste rekomande ose me kthim përgjigje; ose (iii) i është dorëzuar një shoqërie ndërkombëtare të mirënjohur të shërbimit të shpejtë postar, me adresën që Ortaku ka deklaruar pranë Administratorit(ëve) të Shoqërisë.

Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera që Shoqëria i drejton ortakeve sipas këtij Statuti do të konsiderohen se janë marrë rregullisht nga Ortaku në datën me të hershme midis: (i) datës së marrjes

efektive ose refuzimit të pranimit; (ii) datës së kthimit të përgjigjes së njoftimit dërguar me rekomandë; (iii) dhe/ose depozitimit për llogari të Ortakut marrës pranë shërbimit të shpejte postar.

Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera që Shoqëria i drejton ortakëve sipas këtij Statuti mund të kryhen edhe me mjete elektronike. Njoftimet e komunikimet me mjete elektronike vërtetohen sipas Legjislacionit për nënshkrimin elektronik, e u dërgohen Ortakëve në adresat elektronike të deklaruara prej tyre.

Kur kuota e Shoqërisë zotërohet nga më shumë se një person, të gjitha njoftimet i drejtohen përfaqësuesit të bashkëzotëruesve.

Në kuptim të këtij Statuti, shprehjet në njëjës përfshijnë ato në shumës e anasjelltas, me përjashtim të rastit kur sipas kontekstit të dispozitës rezultojnë ndryshe. Përemri vektor “ai” përfshin edhe përemrin vektor “ajo” dhe përemri vektor “atë” i nënkupton të dyja gjinitë, me përjashtim të rastit kur sipas kontekstit të dispozitës rezultojnë ndryshe.

Titulli I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia, Website

Neni 1:

Themelimi, Themeluesit, Emri,

(1) Sot me datë 07/08/2023 Une:

- **Sebastjan HOXHA**, i biri i Elmaz dhe Violeta, lindur me 05/01/2002 në Berat ,banues në Berat , identifikuar nga Letërnjoftimi i tij me Nr 034206110 dhe Nr. Personal K20105058B, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar ;

Themeloj një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin: “**Kalaja e Bardhë**” Shpk

Neni 2:

Objekti i veprimtarisë

Themeluesit e “**Kalaja e Bardhë**” SHPK përcaktojnë objektin e aktivitetit të shoqërisë .

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si më poshtë:

- Ofrimi i shërbimeve online për kujdesin ndaj problematikave që i dalin personelit të Klientëve, gjatë kryerjes së aktivitetit dhe adresimit të problemit në zgjidhje .
- Aktivitet në fushën e marketingut në Web. Aktivitet në fushën e tregtisë elektronike edhe për llogari të palëve të treta. Aktivitet në fushën e ndërmjetsimit dhe përfaqësimit të të tretëve.
- Të zhvillojnë aktivitet në fushën e import, eksport, prodhim e tregtim me shumice dhe me pakice të artikujve industrial, dhe të tjera të ngjashme dhe të lidhura me to.
- Çdo lloj operacioni dhe transaksioni me lidhje me importin, eksportin, prodhimin, shperndarje dhe tregtim të mallrave ushqimor, industrial, konfeksione, paisje mobilerie, druri dhe shtepiake në pergjithësi, elektro-shtepiake, kancelarike dhe të zyrave si me shumice dhe pakice, në natyrën e lëndës së parë, produkteve gjysem të gatshme apo të gatshme, makinerive, paisjeve, pjeseve të ndertimit, teknologjive, perpunim dhe tregtim.
- Blerje, shitje, dhenie me qira të pasurive të paluajtshme. Shitblerje automjetesh dhe dhënia me qera e tyre.
- Dhenie konsulence teknike në fusha të ndryshme që kanë lidhje me objektin e veprimtarisë.
- Tregtim të paisjeve dhe materialeve të ndryshme të sigurisë personale dhe kolektive.

Neni 3:

Kohëzgjatja

Shoqëria themelohet për të ushtruar aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të pacaktuar:

Neni 4:

Selia, Website dhe adresa elektronike, shenjat dalluese të aktivitetit

- (1) Selia e shoqërisë do të jetë në adresën: Rr. "Hamdi Vrioni", Lagja "Muzakaj", Pasuria me numer 15/190 e ndodhur në Zonën Kadastrale 8501, Berat, Shqipëri.
- (2) Shoqëria mund të çele filiale, dege dhe perfaqësi në qytete të tjera të Shqipërisë, në përputhje me Ligjin Tregtar;
- (3) Shoqëria do të ketë Website e saj zyrtar www.kalajaebardhe.al
- (4) Shoqëria do të ketë adresat e saj zyrtare për komunikimet elektronike; info@kalajaebardhe.al
- (5) Shenjat dalluese të aktivitetit, ndryshimet e adresës elektronike dhe të Website, njoftohen vullnetarisht për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
- (6) Markat e Shoqërisë regjistrohen në përputhje me legjislacionin mbi pronësinë intelektuale.

(7) Veprimtaria e shoqërise do të kryhet në përputhje me certifikimet dhe akreditimet e njohura.

Titulli II Kapitali Regjistruar

Neni 5: Kapitali i Regjistruar, Kontributet, Kuotat

(1) **Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është 20 000 (Njezetmije) Lekë.** Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është kontribut në para i themeluesve dhe përbëhet nga një kuotë , sipas raporteve vijuese:

➤ **Sebastjan HOXHA, një kuotë në masën 100 % ose 20 000 lekë.**

(2) Kuotat Shoqërisë mund të pjesëtohen për shkak të kalimit të tyre sipas Ligjit Tregtar.

(3) Kontributet në para paguhen në llogarinë bankare të shoqërisë menjëherë me fillimin e aktivitetit të shoqërisë.

(4) Kontributet e mëtejshme në para për nënshkrimin e kuotave si pasojë e zmadhimit të kapitalit të regjistruar duhet të paguhen tërësisht jo më vonë se 3 muaj nga data e nënshkrimit të kuotave të reja, apo në një datë të ndryshme të përcaktuar nga asambleja e ortakëve.

(5) Një kuotë e Shoqërisë mund të zotërohet nga më shumë se një person fizik a juridik, nëse kjo miratohet nga asambleja e ortakëve nëpërmjet një vendimi të marrë me të njëjtën shumicë të përcaktuar nga neni 87(1) i Ligjit Tregtar.

(6) Kur një kuotë e Shoqërisë zotërohet nga më shumë se një person fizik a juridik, marrëdhëniet mes këtyre personave, si dhe mënyrat e caktimit të përfaqësuesit rregullohen në një marrëveshje të veçantë midis tyre. Një kopje e kësaj marrëveshje duhet të depozitohet pranë Administratorit(ëve) të Shoqërisë. Shoqëria njeh si marrëveshje midis bashkëzotëruesve të një kuote, vetëm marrëveshjen e depozituar pranë Administratorit(ëve). Bashkëzotëruesit e kuotës ushtrojnë të drejtat e detyrimit që rrjedhin nga kuota duke caktuar në marrëveshje mes tyre një përfaqësues të përbashkët, i cili mban me Shoqërinë marrëdhëniet juridike të lidhura me kuotën. Shoqëria mund të refuzojë të kryejë veprime më përfaqësuesin, nëse marrëveshja e veçantë midis bashkëzotëruesve të kuotës nuk është depozituar pranë administratorit(ëve) të Shoqërisë. Pavarësisht nga caktimi i përfaqësuesit, të gjithë personat që zotërojnë në mënyrë të përbashkët një kuotë të Shoqërisë përgjigjen personalisht e në mënyrë solidare për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës. Veprimet e Shoqërisë ndaj kuotës së zotëruar nga më shumë se një person krijojnë pasoja ndaj të gjithë zotëruesve të kuotës, edhe nëse veprimi i Shoqërisë i drejtohet vetëm njërit prej zotëruesve të saj. Për sa nuk parashikohet në këtë paragraf, zbatohen dispozitat e nenit 72 të Ligjit Tregtar.



Neni 6:

Cilësia e Ortakut, Shlyerja e kuotave

(1) Cilësia e Ortakut të Shoqërisë me të drejta të plota, fitohet vetëm pasi vlera e kuotës së nënshkruar prej secilit është shlyer tërësisht. Ortaku Nënshkruar regjistrohet në QKB si Ortak i Shoqërisë me të drejta të plota, vetëm pas shlyerjes së plotë të kontributeve të lidhura me kuotën e nënshkruar. Deri në shlyerjen e plotë të kontributeve të lidhura me kuotën e nënshkruar, Ortaku Nënshkruar njoftohet si i tillë në përputhje me parashikimet e nenit 44 të Ligjit "Për QKB".

(2) Deri në shlyerjen e plotë të kuotës së nënshkruar, Ortaku Nënshkruar nuk ka të drejta të përfitojë dividendë në lidhje me kuotën e nënshkruar, të përfitojë nga të drejtat e parablerjes (në transferimin e kuotave ekzistuese, në blerjen e kuotave që likuidohen, apo nënshkrimin e kuotave të reja etj.) që i njihen Ortakut si dhe kuota e nënshkruar prej tij nuk merret parasysh në llogaritjen e kuorumit të pjesëmarrjes në votimet e asamblesë për çështjet e përcaktuara nga neni 87(1) i Ligjit Tregtar. I njëjti rregull zbatohet në përputhje me dispozitat e nenit 5(8) të Statutit, edhe kur një kuotë e Shoqërisë zotërohet nga më shumë se një person fizik a juridik.

(3) Me kalimin e afatit të shlyerjes së kuotave të nënshkruara me kontribut në para sipas përcaktimeve të nenit 5 më sipër, Administratori(ët), nëpërmjet një njoftimi paraprak prej 14 ditësh të plota, ka(në) të drejtë të vënë në vonesë Ortakun Nënshkruar e t'i kërkojnë pagimin e shumave të pashlyera të nënshkruara prej tij, duke njoftuar vendin dhe kohën e shlyerjes (vonesa). Ortaku Nënshkruar, është i detyruar të paguajë pjesën e pashlyer të kuotave të nënshkruara, në vendin dhe kohën e shënuar në njoftimin e Administratori(ëve). Administratori(ët), mund të lejojnë pagimin në këste të pjesës së pashlyer të kontributeve. Ortaku Nënshkruar, i cili është vënë në vonesë si më sipër, përgjigjet për pagimin e shlyerjen e kontributeve të lidhura me kuotën, edhe nëse kuota e pashlyer i është kaluar një personi të tretë. Personi që ka fituar kuotën e pashlyer, përgjigjet ndaj Shoqërisë për detyrimet e lidhura me kuotën, solidarisht me Ortakun Nënshkruar që e ka kaluar atë.

(4) Kur Ortaku Nënshkruar vihet në vonesë nga Administratori(et), atëherë Ortaku Nënshkruar, duke nisur nga data e caktuar për pagesë sipas pikës 3 më sipër, detyrohet t'i paguajë Shoqërisë një kamatëvonesë ditore të llogaritur me normën prej 7 për qind në vit, të shumës së pashlyer. Gjithashtu, duke mbetur të pacenuara kufizimet sipas paragrafit (2) të këtij neni, deri në datën e shlyerjes së plotë të kontributeve, Ortakut Nënshkruar i pezullohet çdo e drejtë votë në organet e Shoqërisë, si dhe çdo e drejtë tjetër e lidhur me kuotën. Kuotat e nënshkruara prej Ortakut Nënshkruar nuk merren parasysh në llogaritjen e kuorumit.

(5) Nëse pavarësisht vënies në vonesë si më sipër, Ortaku Nënshkruar nuk shlyhen kontributet e lidhura me kuotën e nënshkruar, si dhe kamatëvonesat e akumuluar brenda afatit të caktuar si më sipër, nëpërmjet një njoftimi paraprak prej 14 ditësh të plota, Administratori(ët) mund t'i japë Ortakut Nënshkruar në vonesë një afat të dytë për pagimin e pjesës së pashlyer të kuotës së nënshkruar, së bashku me kamatëvonesat e



akumuluar, me njoftimin që nëse këto shuma nuk paguhen në vendin e kohën e caktuar, Shoqëria mund të anulojë kuotën, ose t'ja ofrojë për shitje të tretëve.

(6) Nëse kontributet për kuotën e nënshkruar dhe kamatëvonesat e akumuluar si më sipër nuk shlyhen në vendin dhe kohën e caktuar nga Administratori(ët), atëherë Shoqëria, nëpërmjet një vendimi të Administratorit(ëve) mund:

a) të ofrojë kuotën për nënshkrim ortakëve të tjerë, proporcionalisht me kuotat e zotëruara prej tyre; apo nëse këta nuk pranojnë nënshkrimin e kuotës:

b) të ofrojë kuotën për nënshkrim të tretëve;

c) të anulojë kuotën në përputhje me nenin 13 të statutit dhe nenit 80 të Ligjit Tregtar;

(7) Në rastet kur Administratori(ët) vendosin që kuota e pashlyer nga Ortaku Nënshkrues t'i ofrohet ortakëve të tjerë apo të tretëve, Administratori(ët) përcaktojnë kushtet dhe afatet e pranimit e nënshkrimit. Anulimi i kuotës kryhet nga Administratori(ët) duke ndjekur procedurat e përcaktuara në nenin 13 të këtij Statuti..

(8) Në rastet e përcaktuara në paragrafin 6 më sipër, Ortaku Nënshkrues nuk ka të drejtë t'i kërkojë Shoqërisë likuidimin e kuotës sipas nenit 13, por, nëse Shoqëria ngre ndaj tij padi për shpërblim dëmi, Ortaku Nënshkrues ka të drejtë të kompensojë shumën që efektivisht i ka paguar Shoqërisë me dëmin e kërkuar nga Shoqëria.

(9) Të drejtat e detyrimit, që i rrjedhin Ortakut Nënshkrues sipas këtij statuti, shuhet në datën e vendin e përcaktuar në vendimin e Administratorit(ëve).

(10) Për bashkëzotëruesit e një kuote zbatohen dispozitat e nenit 5(8).

Neni 7.

Te drejtat e detyrimit qe rrjedhin nga kuotat e reja

(1) Brenda kufijve të parashikimeve të Ligjit Tregtar, dhe pa cenuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, Asambleja e Ortakëve, nëpërmjet një vendimi të marrë me shumicën e parashikuar nga neni 87(1) i Ligjit Tregtar, mund të kufizojë të drejtat që rrjedhin nga kuotat e reja të Shoqërisë, krijuar si pasojë e pjesëtimit të kuotave, apo të zmadhimit të kapitalit.

(2) Asambleja e Ortakëve, me të njëjtën shumicë, e në përputhje me kërkesat e paragrafit të mësipërm, mund të ngarkojë kuotat e reja me detyrime shtesë.

Neni 8.

Çertifikata e Kuotës

Çdo Ortak, pasi fiton këtë cilësi në Shoqëri, ka të drejtë të kërkojë, pa shpenzime shtesë, lëshimin e një çertifikate që vërteton zotërimin e kuotës. Në rastin kur kuota zotërohet nga më shumë se një person, Shoqëria lëshon vetëm një çertifikatë në emër të përfaqësuesit, duke shënuar që ky person mban kuotën me këtë cilësi. Personat që zotërojnë kuotën në mënyrë të përbashkët mund të kërkojnë që emri i tyre të

shënohet në këtë certifikatë. Certifikata e zotërimit të kuotës nuk përbën Titull në kuptimin e Legjislacionit në fuqi mbi Titujt e tregtueshëm.

Neni 9:

Kalimi i kuotave

(1) Kalimi i kuotave bëhet vetëm pasi hyrja e ortakut të ri të miratohet paraprakisht prej Shoqërisë, nëpërmjet një vendimi të asamblesë së ortakëve, që vendos me shumicën e parashikuar nga neni 87(1) i Ligjit Tregtar. Themeluesit, për aq kohe sa të mbajnë cilësinë e Ortakut në Shoqëri, kanë të drejtën e vetos për të penguar ose lejuar hyrjen e ortakëve të rinj. Themeluesit e ushtrojnë të drejtën e vetos sipas këtij neni në unanimitet mes tyre. Kur Shoqëria vendos mospranimin e ortakëve të rinj, Ortakut i likuidohet kuota sipas parashikimeve të paragrafit (4) të këtij neni, dhe nenit 13 të Statutit.

(2) Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim. Kalimi i kuotës së Shoqërisë prodhon efekte sipas kushteve të përcaktuara në të, dhe vetëm pasi një kopje origjinale është depozituar pranë selisë së regjistruar të Shoqërisë, së bashku me dokumentet e identifikimit të fituesit të kuotës, nëse i ndryshëm nga ortakët ekzistues të Shoqërisë.

(3) Në rast vdekje apo falimentimi të një ortakut, Shoqëria sipas parashikimeve të paragrafit 1 të këtij neni, vendos mbi pranimin apo mospranimin, përkatësisht të trashëgimtarit apo personit që ka fituar të drejta mbi pasurinë e ortakut si pasojë e trashëgimisë apo falimentimit.

(4) Në rastin kur Shoqëria vendos mospranimin e trashëgimtarit apo personit që ka fituar të drejta mbi pasurinë e ortakut si pasojë e trashëgimisë apo falimentimit, Shoqëria detyrohet t'i likuidojë këtyre personave kuotën e ortakut, sipas përcaktimeve të nenit 13. Administratori(ët) llogarisin vlerën monetare që do të likuidohet sipas nenit 13, dhe:

- a) ja ofrojnë për blerje ortakëve të tjerë, proporcionalisht me kuotat e zotëruara prej tyre, me të paktën këtë vlerë si çmim shitje;

apo nëse këta nuk pranojnë blerjen e kuotës:

- b) anulojnë kuotën në përputhje me nenin 13 të statutit dhe nenit 80 të Ligjit Tregtar.

(5) Në rastet kur Shoqëria nuk ka vendosur anulimin e kuotës, Administratori(ët) përcaktojnë kushtet e afatet e pranimi të blerjes së kuotës nga Ortakët e tjerë. Në rastin kur Shoqëria vendos likuidimin e kuotës, vlera përkatëse përcaktohet sipas nenin 13. Anulimi i kuotës kryhet nga Administratori(ët) duke ndjekur procedurat e përcaktuara në nenin 13 të këtij Statuti.

(6) Trashëgimtari apo personi që ka fituar të drejta mbi pasurinë e ortakut si pasojë e trashëgimisë apo falimentimit i cili është pranuar nga Shoqëria, zëvendësohet në të drejtat që ortakut i mëparshëm gëzonte në bazë të kuotës. Me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 6 (2), Ortaku i ri zëvendëson ndaj Shoqërisë ortakun e mëparshme për detyrimet e lidhura me kuotën e fituar.

Neni 10.

Zmadhimi i kapitalit



- (1) Asambleja e Përgjithshme, nëpërmjet një vendimi të marrë me shumicën e parashikuar nga neni 87(1) i Ligjit Tregtar mund ta zmadhojë kapitalin e regjistruar të Shoqërisë me kapitalizmin e fitimeve, rezervave, me asetet e tjera të Shoqërisë, apo me kontribute të reja.
- (2) Me përjashtim të rastit kur Asambleja e Përgjithshme me shumicën e parashikuar në paragrafin (1) të këtij neni vendos ndryshe, Ortakët ekzistues, në raport me kuotën e zotëruar prej tyre, kanë të drejtën e parablerjes mbi zmadhimin e kapitalit.
- (3) Dispozitat e nenit 5, paragrafi (5) deri (9) dhe të nenit 6 zbatohen edhe në rastin e zmadhimit të kapitalit. Parashikimet e nenit 6 i zbatohen Ortakëve ekzistues vetëm në lidhje me kuotat e reja të nënshkruar prej tyre.

Neni 11.

Zvogëlimi i kapitalit

- (1) Asambleja e Përgjithshme mund ta zvogëlojë kapitalin e regjistruar të Shoqërisë nëpërmjet një vendimi të marrë me shumicën e parashikuar nga neni 87(1) i Ligjit Tregtar.
- (2) Në rastet kur zvogëlimi i kapitalit nuk bëhet për të mbuluar humbjet e aktivitetit, Asambleja e Përgjithshme mund ta zvogëlojë kapitalin duke autorizuar Administratorin(ët) të anulojnë një apo më shumë kuota në përputhje me parashikimet e nenit 14 të Statutit.

Neni 12.

Blerja e kuotave nga Shoqëria

- (1) Shoqëria, me vendim të Administratorit(ëve), mund të blejë kuotat e saj nga një Ortak me qëllim rishitje brenda mbylljes së vitit fiskal. Ky veprim mund të kryhet me kusht që të përmbushen kërkesa e Nenit 77(2) të Ligjit Tregtar dhe pagesa në lidhje me blerjen e kuotës të kryhet me fonde rezervë, të ndryshme nga ato të lëna mënjane për t'u shpërndarë si dividend apo të përfituara nga një emetim i ri kuotash.
- (2) Në rast se kuotat e blera sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk rishiten brenda mbylljes së vitit fiskal, kuotat e blera nga Shoqëria duhet:
 - a) t'i ofrohen për blerje ortakëve të tjerë të Shoqërisë, proporcionalisht me kuotat e zotëruara prej tyre, me çmim shitje të paktën vlerën e paguar nga Shoqëria, apo nëse këta nuk pranojnë blerjen e kuotës:
 - b) të anulohen në përputhje me nenin 13 të Statutit dhe nenit 80 të Ligjit Tregtar.
- (3) Administratori(ët) që kanë kryer veprimin përgjigjen për demin që i është shkaktuar Shoqërisë nga ky transaksion, e veçanërisht si pasojë e mbivlerësimit të çmimit të shitjes paguar për blerjen e kuotës.
- (4) Nëse blerja kryhet pa u plotësuar kushtet e paragrafit 1, Administratori(ët) që kanë kryer veprimin përgjigjen ndaj Shoqërisë për demin e shkaktuar, e për kthimin e shumave të paguara sipas parashikimeve

të neneve 78 dhe 79 të Ligjit Tregtar. Në këtë rast, Ortaku shitës në përputhje me parashikimet e nenit 78 të Ligjit Tregtar përgjigjet solidarisht me Administratorin(ët) që kanë kryer veprimin.

Neni 13

Anulimi dhe likuidimi i kuotës

- (1) Më përjashtim të rasteve të anulimit të kuotave përcaktuar shprehimisht nga ky Statut, si dhe të largimit apo përjashtimit të Ortakut në përputhje me dispozitat e Ligjit Tregtar. anulimi e likuidimi i kuotës bëhet në marrëveshje me Ortakun që e zotëron atë.
- (2) Anulimi i kuotave vendoset nga Asambleja e Përgjithshme nëpërmjet një vendimi të marrë me shumicën e parashikuar nga neni 87(1) i Ligjit Tregtar. Kur anulimi i kuotave bëhet në rastet e parashikuara nga nenet 6 (6) dhe 12 (2) të këtij Statuti, anulimi vendoset nga Administratori(ët) e Shoqërisë.
- (3) Anulimi i kuotave kryhet nga Administratori(ët) e Shoqërisë në përputhje me parashikimet e këtij Statuti.
- (4) Me përjashtim të rasteve të përjashtimit të Ortakut në përputhje me dispozitat e Ligjit Tregtar dhe të anulimit të kuotave sipas parashikimeve të nenit 6 (6) dhe 12 (2) të këtij Statuti, Shoqëria kryhen likuidimin e kuotës duke i paguar Ortakut, trashëgimtarit apo personit që ka fituar të drejta mbi pasurinë e ortakut si pasojë e trashëgimisë apo falimentimit, një shumë jo më të lartë se:
 - a) vlera e kapitaleve të veta të Shoqërisë, në raport me përqindjen e kapitalit të regjistruar që përfaqëson kuota e likuiduar; dhe
 - b) pjesa e fitimeve vjetore që do t'i takonte ortakut, dhe përcaktuar në Çertifikatën e Aftësisë Paguese në përputhje me nenin 77 të Ligjit Tregtar.
- (5) Kur likuidimi i kuotës kryhet me miratimin e Ortakut që e zotëron atë, shuma që likuidohet llogaritet në marrëveshje me Ortakun.
- (6) Vlera e likuidimit të kuotës llogaritet nga Administratori(ët) në përputhje me bilancin kontabël të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme për vitin fiskal gjatë së cilit vendoset likuidimi i kuotës. Kushtet, kështet dhe afatet e likuidimit të kuotës përcaktohen nga Administratori(ët), duke patur parasysh periudhat e nevojshme për mbylljen e bilancit, apo nevojat e likuiditetit të Shoqërisë.
- (7) Ortaku, trashëgimtarit apo personi që ka fituar të drejta mbi pasurinë e ortakut si pasojë e trashëgimisë apo falimentimit mund t'i kërkojë Administratorit(ëve) që likuidimi i kuotës të kryhet pa vonesa sipas vlerave që rezultojnë nga një bilanc i ndërmjetëm për periudhën përkatëse përpara mbylljes së vitit fiskal, duke pranuar shumat që do të rezultojnë nga ky bilanc, dhe duke hequr dorë nga pretendimi i shumave të mëtejshme në lidhje me likuidimin e kuotës.

Titulli III

Asambleja e Përgjithshme

Neni 14:

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

- (1) Administratori(ët) thërrasin mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme sa herë e mendojnë të arsyeshme për mbarëvajtjen e aktivitetit të Shoqërisë, kur thirrja kërkohet nga ortakët në përputhje me Nenin 84 të Ligjit Tregtar, dhe sa herë që thirrja është e detyrueshme sipas Ligjit Tregtar apo dispozitave të tjera ligjore,
- (2) Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë apo me mjete elektronike, që i drejtohet secilit prej ortakëve, përfshirë edhe përfaqësuesit e kuotave në bashkëzotërim. Njoftimi duhet të bëhet të paktën shtatë ditë të plota pune përpara datës së mbledhjes, por kjo periudhë mund të jetë edhe më e shkurtër nëse kjo miratohet nga shumica e ortakëve. Njoftimi përmban të dhënat dhe informacionin e përcaktuar në nenin 83 të Ligjit Tregtar. Në rast se mbledhja mbahet nëpërmjet komunikimeve elektronike, Ortakëve u njoftohen gjithashtu mënyrat e komunikimit dhe të vërtetimit të nënshkrimeve sipas Legjislacionit për nënshkrimin elektronik, si dhe mënyrat e mjetet e nevojshme për të verifikuar identitetin në mënyrë elektronike.
- (3) Ortaku nuk mund të kërkojë shpalljen e pavlefshmërisë së mbledhjes së asamblesë, nëse Ortaku i ka dhënë Shoqërisë një adresë të pasaktë (përfshi adresën elektronike), apo nuk i ka njoftuar Administratorit(ëve) ndryshimin e adresës (përfshi adresën elektronike) përpara nisjes së njoftimit, apo mosfunksionimin e adresës elektronike përpara nisjes së mbledhjes.

Neni 15:

Punimet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

- (1) Punimet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme nuk mund të fillojnë nëse nuk është plotësuar kuorumi i parashikuar në Nenin 86 të Ligjit Tregtar. Ortakët ose zotëruesit e autorizimit të votimit mund të jenë të pranishëm duke përdorur mjete elektronike sipas Nenit 88 të Ligjit Tregtar. Ortakët që marrin pjesë përmes mjeteve elektronike kanë të drejtë të votojnë pasi identiteti i tyre të verifikohet në mënyrë elektronike sipas përcaktimeve të njoftimit të thirrjes.
- (2) Administratori(ët) drejtojnë punimet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme dhe caktojnë një person për të mbajtur procesverbalin e mbledhjes. Ortakët e pranishëm me të drejtë votë, me shumicën e 3/4 të votave të të pranishmëve mund të vendosin që mbledhja të kryesohet nga një person tjetër.
- (3) Nëse asnjëri prej Administratorëve nuk është i pranishëm në vendin dhe orën e vendosur për të mbajtur mbledhjen, ortakët e pranishëm me të drejtë vote zgjedhin me shumicën e të pranishmeve njërin prej tyre për të drejtuar mbledhjen si Kryetar, dhe një person për të mbajtur procesverbalin e mbledhjes.
- (4) Pavarësisht mbajtjes së cilësisë së Ortakut, Administratori(ët) kanë gjithnjë të drejtë të marrin pjesë dhe të dëgjohen në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme.



(5) Kryetari, përpara nisjes së punimeve të mbledhjes së asamblesë verifikon numrin e ortakëve të pranishëm personalisht apo nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar, si dhe identitetin e numrin e votave të zotëruara, plotësimin e kuorumit për mbajtjen e mbledhjeve e kuorumin e nevojshëm për marrjen e vendimeve sipas rendit të ditës, në baze të listës së pjesëmarrësve me të dhënat e mësipërme. Lista nënshkruhet prej pjesëmarrësve. Në rastin e komunikimeve me mjete elektronike, nënshkrimi i listës së pjesëmarrësve vërtetohet sipas kërkesave të legjislacionit për nënshkrimin elektronik.

(6) Në rast se kuorumi për fillimin e punimeve apo kuorumi për marrjen e vendimeve nuk plotësohet, si dhe në çdo rast tjetër kur mbledhja e asamblesë nuk mbahet në vendin dhe orën e caktuar në njoftimin për thirrje, ajo shtyhet automatikisht pas 7 ditësh, dhe mbahet me të njëjtat mënyra, të njëjtin rend dite, në të njëjtin vend dhe orë të caktuar në njoftimin e parë. Administratori(ët) njoftojnë Ortakët që nuk ishin të pranishëm për shtyrjen e mbledhjes. Në rast se as kjo mbledhje nuk realizohet, Administratori(ët) ripërsërisin njoftimet për thirrjen e mbledhjes një datë tjetër. Administratori(ët) mund të ndryshojnë rendin e ditës, mënyrat e mbajtjes së mbledhjes dhe të dhënat e njoftimit, i cili konsiderohet si një njoftim i ri.

Neni 16:

Votat e ortakëve

(1) Në varësi të drejtave ose kufizimeve të lidhura me kuotat, secili ortak ka të drejtën e aq votave sa është përqindja e kapitalit që përfaqëson kuota e tij.

(2) Vendimet e Asamblesë merren me shumicën e votave të përcaktuar në nenin 87 të Ligjit Tregtar.

(3) Vendimet Asamblesë merren me votë të hapur, nëse përpara deklarimit të rezultatit nuk është kërkuar një votim i fshehtë. Votimin i fshehtë mund të kërkohet nga Kryetari ose nga ortakë që zotërojnë jo më pak se 20% të votave të asamblesë, apo nga përfaqësuesit e tyre të autorizuar.

(4) Nëse nuk kundërshtohet nga një ortak, deklarimi i Kryetarit në lidhje me miratimin apo rrëzimin e një vendimi nga asambleja e përgjithshme, si dhe në lidhje me shumicën me të cilën është votuar, regjistrohet në procesverbalin e mbledhjes dhe konsiderohet i formës së prerë, pa pasur nevojë për provën e numrit apo përqindjes së votave të regjistruara pro ose kundër vendimit. Nëse ka kundërshtime, ky fakt shënohet në procesverbal, dhe Kryetari numëron votat pro ose kundër, dhe nëse ka paqartësi, asambleja voton për herë të dytë çështjen.

(5) Mënyrat e votimit të fshehtë përcaktohen në rregulloren e punimeve të asamblesë. Në rastin e votimit me mjete elektronike, mënyra e votimit garanton fshehtësinë e votës.

(6) Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme regjistrohen në procesverbalin e mbledhjes. Procesverballi përmban datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, mënyrën e mbajtjes së mbledhjes dhe të votimit, rezultatet e votimit, regjistrimin e zhvillimit të mbledhjes e çështjet e tjera që duhet të shënohen në të sipas Ligjit Tregtar apo rregullores së punimeve të asamblesë.

(7) Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, autorizimet për votim (nëse ka), si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme. Në rastin kur mbledhja zhvillohet me mjete elektronike, procesverbalit i bashkëngjiten gjithashtu kopjet e printuara të dokumenteve elektronike që vërtetojnë pjesëmarrjen e nënshkrimit elektronik. Procesverbali i mbledhjes, lista e pjesëmarrësve e dokumentet e tjera të bashkëlidhura, nënshkruhen nga Kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

(8) Administratori(ët) përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme. Administratori(ët), për qëllime të aktivitetit tregtar, e në rastin kur procesverbali i mbledhjes përmban të dhëna konfidenciale për aktivitetin e Shoqërisë, mund të nxjerrin ekstrakte të këtyre procesverbaleve, e në raste kur këto ekstrakte kërkohen të vërtetuara, duke kërkuar asistencën e noterit pasi ky i fundit të ketë deklaruar mbajtjen konfidenciale të të dhënave të tjera të procesverbalit.

(9) Administratori(ët), jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes i njoftojnë Ortakëve apo përfaqësuesve të tyre kopje të procesverbalit, dhe nëse kjo është vendosur nga asambleja e publikojnë atë në një seksion të veçantë të website të aksesueshem vetëm nga ortakët.

(10) Në rastet kur mbledhja mbahet nëpërmjet komunikimeve elektronike, ajo konsiderohet e mbajtur në orën dhe vendin e selisë së regjistruar të Shoqërisë.

Neni 17:

Votimi me Autorizim

(1) Ortaku mund të autorizojë persona të tjerë sipas kushteve të lejuara nga Ligji Tregtar për ta përfaqësuar atë në mbledhjet e asamblesë. Autorizimi bëhet me shkrim sipas formës së përmbajtur në Aneksin 1 (ose sipas një forme tjetër të miratuar nga Administratori(ët) e që i është njoftuar ortakëve):

(2) Autorizimi origjinal me shkrim apo një kopje e noterizuar ose e vërtetuar nga Administratorët duhet të depozitohet në selinë e Shoqërisë jo më vonë se 24 orë përpara orës së datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë. Autorizimi i depozituar pas këtij afati nuk mund të përdoret në mbledhjen e asamblesë.

(3) Autorizimi mund të jepet me mjete elektronike, me kusht që të jepet sipas formatit të përcaktuar në këtë Statut, të dërgohet jo më vonë se 24 orë përpara orës së datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë nëpërmjet një mesazhi elektronik në adresën elektronike të caktuar nga Neni 4 paragrafi 3 i këtij Statuti, e nënshkrimi i saj të vërtetohet sipas legjislacionit për nënshkrimin elektronik.

Neni 18

Asambleja e Përgjithshme ka kompetencat e mëposhtme:

- Percakton politikat tregtare të shoqërisë.
- Ka të drejtë të bëjë ndryshime në statut.
- Ka të drejtë të miratojë bilancin e shoqërisë dhe të bëjë ndarjen e fitimit.
- Ajo emron administratorët, zëvendësin, ekspertet dhe revizorët kontabël.

- Ajo aprovon cdo lloj veprimi financiar që me ligj dhe me marrëveshje lihet në kompetencë të saj .
- Ajo mund të shfuqizojë ndalimin e konkurrencës (Ligji 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", neni 17, pika 1), nepermjet nje autorizimi te posaçem .
- Përcakton shpërblimin për administratorët, ekspertët, revizorët kontabel.
- Bën transferimin e kuotave të të tretet.
- Bën lidhjen e kontratave për dhenie dhe marrje të drejtash ose ekskluzivitet për tregtimin dhe prodhimin e mallrave të shoqërisë si dhe kontrata në lidhje me organet shtetërore për pjesëmarrjen në tender, ankande ose aktivitete të tjera të rëndësishme.
- Realizon blerje, shitje si dhe tjetërsim të pasurive të paluajtshme të shoqërisë etj.
- Ka të drejtë të bëjë modifikimin e kontratës së shoqërisë.

Titulli IV

Administratorët

Neni 19:

Emërimi i administratorëve

(1) Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administrator të shoqërisë për deri në **pesë vjet** sipas Nenit 81 paragrafi (1) pika 3 dhe Nenit 95 të Ligjit Tregtar. Emërimet i nënshtrohet individualisht një vendimi të zakonshëm me shumicën e parashikuar nga neni 87(2) i Ligjit Tregtar.

(2) Kufizimet në lidhje me emërimin e administratorëve parashikohen në Nenin 95 paragrafi (2) të Ligjit.

(3) Personat e mëposhtëm emërohen si administratorë të parë të Shoqërisë deri në zgjedhjen e bërë nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

(Të dhënat e identifikimit dhe specimeni i nënshkrimit):

Të dhënat e Administratorit	Specimeni i nënshkrimit
<ul style="list-style-type: none"> • Sebastjan HOXHA , i biri i Elmas dhe Violeta, lindur me 05/01/2002 në Berat ,banues në Berat , identifikuar nga Letërnjoftimi i tij me Nr 034206110 dhe Nr. Personal K20105058B, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar ; 	
Afati i emërimit 5 vjeçar.	

Neni 20:

Kompetencat e Administratorëve

- (1) Veprimtaria tregtare e Shoqërisë administrohet nga Administratori(ët), i cili/të cilët, në emër e për llogari të Shoqërisë, kanë të drejtë të kryejnë të gjitha veprimet sipas nenit 95 të Ligjit Tregtar, dhe çdo veprim tjetër që Statuti apo Neni 81 i Ligjit Tregtar nuk ja rezervon shprehimisht Asamblesë së Përgjithshme. Ndryshime e Statutit apo direktivat e mëvonshme nga ana e Asamblesë së Përgjithshme nuk mund të sjellin pavlefshmërinë e veprimeve të mëparshme të Administratorit(ëve), të cilat do të ishin të vlefshme nëse nuk do të ishte bërë ndryshimi apo nëse nuk do të ishte dhënë direktiva.
- (2) Administratori(ët) mund t'u delegojnë personave të tretë kryerjen e veprimeve që përfshihen në një apo disa nga kompetencat që i njihen, por duke mbikëqyrur në çdo rast veprimin e këtyre personave. Administratori(ët) nuk mund t'u delegojnë personave të trete detyrimet të cilat i ngarkohen nga Ligji Tregtar.
- (3) Administratori(ët) kanë të njëjtat të drejta e detyrime, dhe i ushtrojnë ato në përmbushje të kompetencave që u njihen nga Ligji Tregtar apo nga Statuti, veçmas njeri -tjetrit.

Neni 21:

Shpërblimi i punës, përfitimet e tjera dhe shpenzimet e Administratorëve

- (1) Administratorët kanë të drejtë të marrin shpërblim për punën e tyre sipas vendimit të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme me shumicën e parashikuar nga neni 87(2) i Ligjit Tregtar, e sipas Nenin 97 të Ligjit.
- (2) Asambleja e Përgjithshme mund të japë përfitime në të holla, pensione, sigurime ose forma të tjera të përcaktuara sipas një vendimi të zakonshëm të asamblesë me shumicën e parashikuar nga neni 87(2) i Ligjit Tregtar.
- (3) Administratorit(ëve) u paguhen të gjitha shpenzimet e udhëtimit, qëndrimit apo të tjera që u lindin në lidhje me përmbushjen e kompetencave të tyre, apo në pjesëmarrjen në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 22:

Përfundimi i mandatit

Administratorit(ëve) u përfundon mandati për ushtrimin e të drejtave e detyrimeve në përmbushje të kompetencat që u njihen nga Ligji Tregtar apo nga Statuti kur:

1. mbaron afati i detyrës në bazë të dispozitave të Ligjit Tregtar.
2. ndaj tij niset një procedure falimentimi;
3. vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;

4. jep dorëheqjen;
5. ndodhet në një nga situatat e papajtueshmërisë përcaktuar në Ligjin Tregtar; ose
6. shkarkohet nga asambleja.

Titulli V
MARRDHENIET E PUNES

Neni 23

Mardheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria private merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesuarit jane te detyruar qe te respektojne Statutin e kesaj shoqerie dhe rregullat e brendshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigjen per demet qe i shkaktojne kesaj shoqerie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETIT

Neni 24

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te tretet e te gjitha akteve dhe dokumentave qe jane percaktuar si te tilla nga administratori i kesaj shoqerie.

EKSPERTET OSE REVIZORET KONTABEL

Neni 25

Kontrolli mbi veprimtarine e Administratorit dhe Asamblese se Pergjithshme, si dhe gjithe aktiviteti i shoqerise i besohet nje eksperti ose revizori kontabel. Ky ekspert do te qendroje ne detyre per aq sa percaktohet me ligj dhe mund te rizgjidhet. Asambleja cakton dhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te veçanta ligjore.

BILANCI DHE FITIMET

Veprimtaria ekonomike e shoqerise do te mbyllet ne dt. 31 Dhjetor të çdo viti. Administratori merr masa per hartimin e bilancit dhe rezultatin ekonomik fitim - humbje dhe inventar. Pasi paguhen detyrimet fiskale dhe veçohen fondet per zhvillimin e aktivitetit , te ardhurat qe mbeten mund të ndahen ne mes ortakeve te shoqerise dhe mund te transferohen lirisht jashte shtetit sipas dispozitave perkatese ligjore.

Neni 26

Ne rast se kapitali i shoqerise për shkak te humbjeve te realizuara rezulton me pak se kapitali themeltar, ortakët mund te vendosin brenda 4 muajve mundesine e prishjes se jashtezakonshme te shoqerise.

DIVIDENDËT DHE REZERVAT



Neni 27:

Dividendët

- (1) Pas përmbushjes së kërkesave të Nenit 77 të Ligjit, Shoqëria mund të shpallë ndarje dividendë në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve që i përfitojnë ato sipas Ligjit Tregtar apo Statutit.
- (2) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotën, dividendët deklarohen dhe u paguhen ortakëve në përputhje me përqindjen e kapitalit që përfaqëson kuota e zotëruar prej tyre. Dividendi paguhet në një ose disa këste, duke patur parasysh nevojat e likuiditetit të Shoqërisë.

Neni 28:

Rezervat

Asambleja e përgjithshme, me propozim të Administratorit(ëve), nga fitimet e aktivitetit mund të krijojë rezerva të posaçme për mbarëvajtjen e aktivitetit të Shoqërisë.

Titulli VI

Prishja dhe Likuidimi

Neni 29:

Prishja dhe likuidimi

- (1) Shoqëria priset në rastet e parashikuara nga Ligji Tregtar. Prishja e Shoqërisë ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
- (2) Shoqëria mund të likuidohet me procedurë normale apo procedure të thjeshtëzuar, sipas parashikimeve të Ligjit Tregtar.
- (3) Themeluesit, për sa kohe kanë cilësinë e ortakut të Shoqërisë, pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, gëzojnë radhë preference në shpërndarjen e aktiveve të mbetura nga likuidimi.
- (4) Likuidimi i Shoqërisë, për sa nuk parashikohet në këtë Statut, rregullohet nga dispozitat e Pjesës VI, Likuidimi në Gjendjen e Aftësisë Paguese, të Ligjit Tregtar.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË "Kalaja e Bardhë" SHPK

Sebastjan HOXHA

Sebastjan Hoxha 